

## Dhoma e Biznesit të Diasporës bëhet anëtare e Këshillit të Investimeve




Këshilli i Ministrave miratoi vendimin "Për disa ndryshime në Vendimin nr. 294, të datës 08. 04.2015, "Për krijimin e Këshillit të Investimeve", Sipas vendimit të ndryshuar, Këshilli të Investimeve do t'i shtohet si anëtarë Dhoma e Biznesit të Diasporës. Dhoma e Biznesit të Diasporës është një institucion që ka për qëllim krijimin e një fryme bashkëpunimi ekonomik mbarëshqiptar, nëpërmjet nxitjes së investimeve direkte dhe partneriteteve, ofrimit të informacionit të detajuar për të nxitur dhe orientuar sipërmarrjet dhe kapitalin investues të Diasporës në ekonominë e vendit. Gjithashtu sipas vendimit edhe Fondi Shqiptar për Zhvillimin e Diasporës, bëhet anëtar me status të përhershëm në Këshillin e Investimeve.

## Interpelanca për të drejtën e votës me përfaqësues nga Kanada



Ministri i Shtetit për Diasporën, z. Pandeli Majko zhvilloi një video konferencë me grupin e interesit nga Kanada, për të drejtën dhe garantimin e votës së shtetasve shqiptarë jashtë atdheut. Masat e marra nga Komisionit i Reformës Zgjedhore apo institucione të tjera përgjegjëse. Roli i komunitetit të Diasporës, mbështetja nga qeveritë dhe institucionet në vendet. Bisedën e plotë mund ta ndiqni këtu: <https://www.facebook.com/edirama.al/videos/3091995687483268/>

## Aplikacioni informues "Diaspora Shqiptare"



App store [këtu](#): Play store [këtu](#):

## "Raporto" problemin në çdo kohë në Ambasadalme



App store [këtu](#): Play store [këtu](#):

## KKD / Lazim Destani: "Diaspora shqiptare ka energji, kapital, dije dhe kapacitet për investime në vendlindje"

"Diaspora shqiptare ka energji, kapital, dije dhe kapacitet për investime në vendet tona", kështu është shprehur Lazim Destani, kryetar nderi i Rrjetit të Bizneseve të Diasporës dhe anëtar i Këshillit Koordinues të Diasporës në një intervistë të dhënë gjatë kongresit të II-të Ekonomik të "Unionit të Bizneseve Shqiptaro-Gjermane". Biznesmeni i suksesshëm shqiptar shpreson që në të ardhmen të ketë më tepër investime nga Diaspora në të gjitha trojet shqiptare, ai gjithashtu porositi gjithsecilin që të ketë besim në kapitalin dhe në investimin e tij.



## Për tu ndjekur

27 Nëntor, Hapja e Dhomës së Biznesit të Diasporës



1 Dhjetor, Koncerti i Ansambllit Kombëtar në SHBA



## KKD / Adriana Fishta Bejko takim me komunitetin për bashkëpunim me Shqipërinë



Anëtarja e Këshillit Koordinues të Diasporës, Adriana Fishta Bejko këtë fundjavë zhvilloi një takim me komunitetin shqiptar në qytetin e Albertës në Calgary, Kanada për të diskutuar rreth problematikave dhe shqetësimeve të komunitetit, Diasporën shqiptare dhe mënyrat e bashkëpunimit me vendin e tyre të origjinës. Ajo u shpreh se rezultatet e arritura nga ky takim do të prezantohen në mbledhjen e parë të Këshillit Koordinues të Diasporës që do të zhvillohet në Tiranë më 18 dhjetor.

## KKD/ Mark Gjonaj në edicionin e 29-të festivalit shqiptar në New York



Festivali i përvitshëm shqiptar në Nju Jork një dëshmi e ruajtjes së vlerave kombëtare në komunitet. Për gati tre dekada ky komunitet organizon mbledhjen më të madhe festive kulturore shqiptare ku nëpërmjet këngëve dhe valleve folklorike të interpretuara nga artistë të komunitetit shqiptar në Amerikë, synohet promovimi dhe ruajtja e traditave dhe vlerave artistike të kombit shqiptar. I pranishëm në këtë festival ishte anëtar i Këshillit Bashkiak të Nju Jorkut dhe anëtar i KKD-së, Mark Gjonaj, i cili kërkoi nga komuniteti shqiptar në Amerikë që të mos kursehet ndihma për vendlindjen. Festivali i 29-të shqiptar është një nga shumë veprimtaritë e parashikuara të organizohen me rastin e 107-vjetorit të Pavarësisë së Shqipërisë, këtë vit festivali iu dedikua figurës së Ismail Qemalit.

## "Shoqata Albania" lançon dy projekte për studentët shqiptarë në Francë



Anila Hyka Smorgrav, anëtare e Këshillit Koordinues të Diasporës dhe anëtare në Këshillin Drejtues të Fondit Shqiptar për Zhvillimin e Diasporës, është bërë pjesë e aktivitetit të "Shoqatës Albania" me studentë dhe të rinj shqiptarë në Francë, ku janë lançuar dy projektet e shoqatës. Projekti i parë është iniciativë e dy intelektualëve shqiptarë dhe është ideuar ngritja e një grupi pune prej 10 vullnetarësh me qëllim për të informuar studentët shqiptarë atje, rreth proceseve administrative, gjuhësore dhe integruese në zonat, ku ata jetojnë. Gjatë takimit janë diskutuar nevojat e studentëve shqiptarë dhe përmirësimi i imazhit të komunitetit shqiptar në Francë. Ndërsa projekti i dytë në bashkëpunim me studentët dhe universitetin e Tours të Francës ka si qëllim mbledhjen e fondeve nga bizneset franceze për të mbështetur shkollat fillore, 9-vjeçare si dhe gjimnazet në Shqipëri, të cilat rrezikojnë mbylljen ose janë në nevojë për mbështetje.

## KKD / Gazmend Kapllani sërish me botime të suksesshme në Greqi



Autori Gazmend Kapllani sërish me botime të suksesshme në Greqi. Vepra e tretë e tij "Η ΤΕΛΕΥΤΑΙΑ ΣΕΛΙΔΑ" (Faaja e fundit) do të ripublikohet nga shtëpia botuese "Επικειντρο" (Epiqendro), ndërkohë që vepra e tij e fundit në greqisht "λαθος χωρα" (Vendi i gabuar) është në proces dramatikimi dhe do të vihet në skenë së shpejti.

## Fëmijët shqiptarë në Postojna, Sllovenisë mësojnë shqip me tekstet e QBD

Fëmijët shqiptarë në Postojna të Sllovenisë do të mësojnë shqip me tekstet e dërguara falas nga Qendra e Botimeve për Diasporën në bashkëpunim me Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe nën kujdesin e Ministrisë së Shtetit për Diasporën. Veprimtari shqiptar Besim Hajdari, me banim në Postojna është angazhuar për rifillimin e mësimin plotësues në gjuhën shqipe për fëmijët me banim në këtë qytet dhe tashmë ka marrë tekstet në dorëzim për klasën e tij.



## Këshilli Drejtues i FSHZHD zhvillon mbledhjen e radhës



Këshilli Drejtues i FSHZHD zhvillon mbledhjen e radhës, gjatë së cilës u prezantuan donatorët dhe bashkëpunëtorët e FSHZHD-së: Marrëveshjet dhe Memorandumet kombëtare dhe ndërkombëtare të realizuara nga FSHZHD; Arritjet e projektit "Diaspora për Zhvillim", të projektit "Diaspora Shkencore për Zhvillim", të projektit "Diaspora e Integritimit Evropian të Shqipërisë" si dhe të projektit për "Dhomën e Biznesit të Diasporës- Krijimi dhe Nxitja e Investimeve të Diasporës në Shqipëri".